

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**—Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Tonka Berishaj, kryetare, Xhevdet Abazi dhe Abdullah Ahmeti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Eroll Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.M, nga fshati ..., Komuna e ..., për shkak të veprës penale vrasje e rëndë në tentativë në bashkëkryerje, nga neni 147 par.3 e lidhur me nenin 20 e 23 të KPK, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit, av.M.H, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P.nr.705/2011, të dt.17.12.2012, në seancën e kolegjit të mbajtur me 14.02.2014, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Me aprovimin e pjesërishëm të ankesës së mbrojtësit të të akuzuarit A.M, por edhe sipas detyrës zyrtare NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P.nr.705/2011 të dt.17.12.2012, përkitazi me cilësimin juridik të veprës penale për të cilën i akuzuari, shpallet fajtor dhe vendimit për dënim, ashtu që Gjykata e Apelit, veprimet e të akuzuarit A.M, juridikisht i cilëson si vepër penale vrasje në tentativë në bashkëkryerje, nga neni 146 e lidhur me nenin 20 e 23 të KPK-së, për të cilën vepër penale e gjykon me dënim burgu në kohëzgjatje prej 2(dy)vite, në të cilin i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt.20.05.2011, e gjerë më dt.17.12.2012.

## A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P.nr.705/2011, të dt.17.12.2012, i akuzuari A.M, është shpallur fajtor për shkak të veprës penale vrasje e rëndë në tentativë në bashkëkryerje, nga neni 147 par.3 e lidhur me nenin 20 e 23 të KPK, dhe është gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 4(katër)vite e 6(gjashtë)muaj, në të cilin dënim është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt.20.05.2011, deri me dt.17.12.2012. E ka detyruar të akuzuarin, që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në shumë prej 100Euro, në emër të shumës së paushallit gjyqësor.

I dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka paraqitur:

-Mbrojtësi i të akuzuarit A.M, av.M.H, nga Prishtina, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit për dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe i akuzuari të lirohet nga akuza.

Gjykata e Apelit, seancën e kolegjit e caktoi konformë dispozitës së nenit 390 të KPPK, për të cilën në mënyrë të rregullt njoftoj Prokurorinë e Apelit, të dëmtuarin, të akuzuarin dhe mbrojtësin e tij, ndërsa në seancën e kolegjit prezantoi vetëm Prokurori i Apelit-Sabri Ademi, i cili ngeli në tërësi pranë propozimit me shkrim PPA/I.nr.386/13, të dt.05.11.2013, duke propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet ndërsa aktgjykim i ankimuar të vërtetohet. Në seancën e kolegjit edhe pse të ftuar në mënyrë të rregullt nuk prezantuan i akuzuari, mbrojtësi i tij, e as i dëmtuari edhe pse ka prova se janë ftuar në mënyrë të rregullt.

Prokuroria e Apelit, me parashtrësën PPA/I.nr.386/2013, të dt.05.11.2013, ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, pasi që i shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje penalo-juridike, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK dhe pasi vlerësoi pretendimet e theksuara në ankesë, gjeti se:

Ankesa është pjesërisht e bazuar.

Meqë me ankesën e ushtruar aktgjykimi i shkallës së parë, nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë kjo gjykatë të njëjtin e vlerësoi edhe në këtë aspekt, sipas detyrës zyrtare, e në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK dhe konstatoi se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Përkitazi me bazën ankimore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike me ankesë mbrojtësi i të akuzuarit, konteston aktgjykimin ankimuar, duke theksuar se i aktgjykimi i shkallës së parë, në tërësi mbështetet në deklaratën e të dëmtuarit dhe dëshmitarëve, duke mos e marr parasysh fare mbrojtjen e të akuzuarit, i cili deklaroi se ditën kritike para hotelit "...", ka qëndruar me V.G dhe V, ndërsa 2-3m. larg ka qenë L. V, me nofkën "...", ku më vonë vije personi i quajtur Berat, i cili posa bisedon me personat në fjalë kanë filluar të rrahën dhe atë B, me shokët e tij në njërin anë dhe shokët e të akuzuarit, në anën tjetër dhe për një moment duke shikuar ka dëgjuar B, kur ka thënë "O më therën", që d.m.th. se i akuzuari fare nuk ka marrë pjesë në rrahje e as që e ka therur të dëmtuarin, por këtë e kanë bërë persona të tjerë.

Gjykata Apelit, vlerëson se pretendimet e lartcekura ankimore nuk qëndrojnë.

Në bazë të shkresave në lëndë provave të administruara në seancën e shqyrtimit gjyqësor, nuk është kontestuese se në datën 09.05.2011, rreth orës 20:00min. në rr. "...", në

afërsi të hotelit "...", në ..., pas një zënke ka ardhur deri te konflikti edhe fizik në mes disa të rinjve, gjegjësisht të rinjve në grupin e të akuzuarit A, dhe atyre që ishin në grup së bashku me të dëmtuarin B, ku pastaj të dëmtuarit B, pasi më parë i vërsulen dy persona me thikë në dorë-para, duke shkuar në drejtim të të dëmtuarit, ku njëri nga ta e godet të dëmtuarin B dhe atë në pjesën e majtë të trupit në nënsqetull, duke shkaktuar kështu lëndime të rënda trupore, lëndime këto të cilat gjykata e shkallës së parë, i ka vërtetuar edhe përmes ekspertizës mjeko-ligjore, ku është konstatuar se i dëmtuari është goditur me mjet të rrezikshëm me teh, duke pësuar kështu plagë prerëse, shpuese në regjionin infraskapular të majtë, lëndime këto të natyrës së rëndë e me karakter të dëmtimit të përkohshëm të shëndetit.

Kontestuese në rastin konkret në këtë çështje penale-juridike mbesin faktet, se kush e goditi me thikë të dëmtuarin e duke i shkaktuar kështu lëndime të rënda trupore, për çka përkritazi me këtë gjykata e shkallës së parë, ka dëgjuar të dëmtuarin-dëshmitarin B.M, nga i cili me pa mëdyshje ka vërtetuar se ditën kritike pasi i dëmtuari ka dalur para hotelit "...", në ..., së bashku me shokët e tij P, e që aty ishte edhe shoku tjetër Arianiti, ka filluar një fjalosje në mes të A,dhe personit me pseudonimin "...", që ishte shok i të akuzuarit A, ku i akuzuari A, pastaj e ka sharë A, dhe në mes tyre tani fillon konflikti fizik dhe menjëherë i akuzuari A, dhe shoku i tij L, i kanë nxjerrë thikat e tipit "Rombollka" dhe kanë shkuar në drejtim të të dëmtuarit, ku L, edhe pse tenton ta godas të dëmtuarin i njëjti pasi që pengohet nga personat e tjerë nuk arrin ta qëllojë të dëmtuarin, ndërsa i akuzuari A, me thikën e tipit "Rombollka", e ka goditur të dëmtuarin nga prapa dhe atë me pjesën e majtë të trupit në nënsqetull. Faktet në fjalë gjykata e shkallës së parë, i ka vërtetuar edhe nga deklarata e dëshmitarit P.M, i cili deklaron se natën kritike pasi i dëmtuari B, fillon të bisedojë me të akuzuarin dhe shokët e tij, ata më parë e kanë sharë B, dhe pastaj i kanë parë kur A dhe L, i kanë nxjerrë thikat e mëdha të tipit "Rombollka" dhe që te dy kanë shkuar në drejtim të B, por mire shumë e ka vërejtur kur i akuzuari A, e ka goditur të dëmtuarin B, me thikë në nënsqetull, duke shkaktuar kështu lëndime të rënda trupore dhe pastaj për shkak të ndërhyrjes së personave të tjerë të njëjtit janë larguar nga vendi i ngjarjes.

Në kontest të rrethanave të cekura më lartë, gjykata e shkallës së parë, ka marrë parasysh edhe mbrojtjen e të akuzuarit, se i njëjti nuk është pikërisht i akuzuari, personi që e ka goditur me thikë të dëmtuarin, por gjykata e shkallës së parë, e ka vlerësuar si të pabazë dhe të pa argumentuar ngase me asnjë provë i akuzuari nuk ka arritur të argumentojë faktet në fjalë, ndërsa duke gjetur se deklarata e të dëmtuarit gjen mbështetje edhe në provat tjera të administruara në seancën e shqyrtimit gjyqësor, e sidomos në deklaratën edhe të dëshmitarit në vendin e ngjarjes, ka konkluduar se i akuzuari, është pikërisht personi që e ka goditur të dëmtuarin me thikë dhe i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore, të cekura më detajisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Prandaj nga këto arsye, si dhe arsyerat e dhëna në aktgjykimin e ankimuar pretendimet e mbrojtësit janë të pa bazuara, përkritazi me këtë bazë ankimore, ndërsa konkludimet e gjykatës së shkallës së parë, janë të drejta dhe të ligjshme dhe të njëjtat kanë mbështetjen në provat e administruara, të cilat drejt i ka vlerësuar dhe në përputhshmëri me dispozitën e nenit 361 të KPPK. Për faktet vendimtare të kësaj çështjeje penalo-juridike,

gjykata e shkallës së parë, jo vetëm që nuk ka lënë dilema, por përkundrazi në mënyrë të padyshtimtë ka vërtetuar të gjitha faktet relevante dhe për konkludimet e veta në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar ka dhënë arsye të duhura, të cilat i aprovon edhe kjo gjykatë.

Në kuadër të gjendjes faktike të vërtetuar si më lartë, Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në rastin konkret ka bërë shkelje të Ligjit Penal, nga neni 385 par.1 nën par.4 të KPPK-së, shkelje kjo e cila shqyrtohet sipas detyrës zyrtare, konformë dispozitave të nenit 394 të KPPK, ngase ka aplikuar dispozitat ligjore të KPK-së, të cilat nuk ka mundur të aplikohen në rastin konkret, ngase duke gjetur se gjykata e shkallës së parë faktet vendimtare i ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe objektive, por duke marrë parasysh gjendjen e vërtetuar faktike si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, ku nuk rezulton se i akuzuari të ketë vepruar në mënyrë dinake apo mizore, atëherë me zbatimin e drejtë të ligjit është dashur të merret aktgjykim me cilësim tjetër juridik të veprës penale dhe vendosi që aktgjykimi i shkallës së parë, të ndryshohet, përkitazi me cilësimin juridike të veprës penale, ashtu që veprimet inkriminuese të akuzuarit, i cilësoi si vepër penale e vrasjes në bashkëkryerje në tentativë, nga neni 146 lidhur me nenin 20 e 23 të KPK-së. Në rastin konkret në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike nuk mund të bëhet fjalë për mënyrën mizore të kryerjes së veprës penale, nga se i akuzuari pasi më parë fillon konfliktin fizik me të dëmtuarin, në ndërkohë, pra në vijim të konfliktit e godet me thikë të dëmtuarin duke vepruar kështu aty për aty, që do të thotë se nuk mund të vërtetohet se qëllimi-dashja e të akuzuarit të ketë qenë që tek i dëmtuari të shkaktoj dhimbje posaçërisht të mëdha fizike apo psikike, element ky qenësor për kualifikimin e veprës penale të Vrasjes në tentativë në vrasje mizore në tentativë, që gjithashtu nuk mund të vërtetohet se tek i dëmtuari të jenë shkaktuar dhimbje të mëdha të jashtëzakonshme, e që të jenë ekstrem në krahasim me dhimbjet normale, që kërkohet në këto raste, pra nuk është vërtetuar se dhimbjet në rastin konkret të kenë tejkaluar intensitetin e dhimbjeve në raste normale, element ky tjetër që duhet të plotësohet në mënyrë komulative me elementin e cekur më lartë, për të ekzistuar vepra penale e Vrasjes së rëndë në tentativë sipas paragrafit 3 të nenit 147 të KPK. Poashtu në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga shkalla e parë nuk rezulton se i akuzuari të ketë vepruar në mënyrë dinake, vetëm se të dëmtuarin e godet me thikë nga prapa, kur i dëmtuari në rastin konkret vetëm fillon të ikë nga vendi i ngjarjes dhe se konflikti fizik ende ka qenë në kontinuitet-vazhdimsi dhe goditja me thikë nuk ka qenë në mënyrë të befasishme- të pa pritur, nga se i dëmtuari përveç që ka qenë në konflikt fizik i njëjti po ashtu e ka pa të akuzuarin kur i është vënë prapa dhe po ashtu e ka vrejtur mirë duke tentuar ta godas me thikë, gjë që pastaj edhe e bën- pra edhe e godet, dhe i gjithë ky ka qenë një veprim në vazhdimsi, pa elemente të dinakris apo sjellje mashtruse dhe se i dëmtuari po ashtu nuk ka qenë i privuar nga mundësia që të reagoj ndaj sulmit nga se ai e ka par sulmin e drejtëpërdrejtë që po ndodh- pra nuk mund të flitet për elementet e mashtrimit gjegjësisht shfrytëzimit të besimit apo sinqeritetit të të dëmtuarit nga ana e të akuzuarit, para se të njëjtin ta godet me thikë e që të mund të konstatohet se vepra penale në fjalë të jetë kryer në mënyrë dinake.

Duke e shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata Apelit, gjen se pretendimet ankimore të mbrojtësit, po ashtu pjesërisht janë të bazuara. Duke patur parasysh cilësimin tjetër juridik të veprës penale kjo gjykatë me rastin e caktimit të llojit dhe

lartësisë së dënimit, ndaj të akuzuarit vlerësoi të gjitha rrethanat relevante për matjen dënimit, duke i aprovuar kështu ato të konstatuara, por edhe të vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë, e duke marrë parasysh tani cilësimin tjetër juridik të veprës penale dhe të akuzuarit, i shqiptoi dënim me burg në kohëzgjatje prej 2(dy)vite, me bindje se ky dënim si në dispozitiv tani është në përpjesëtim me rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, të përgjegjësive penale të akuzuarit dhe se me këtë po ashtu do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPK-së.

Nga çka u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.nr.422/2013, me dt.14.02.2014**

**Procesmbajtësi,**  
**Eroll Gashi**

**Anëtarët e kolegjit,**  
1. \_\_\_\_\_  
**Xhevdet Abazi**  
2. \_\_\_\_\_  
**Abdullah Ahmeti**

**Kryetare e kolegjit,**  
**Tonka Berishaj**